1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Bashkengjitur

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Bashkia Cerrik

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuara nga Operatori Ekonomik ofertues, dokumente këto të leshuara nga Administrata Tatimore, gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik, konkretisht të viteve financiare 2019,2020, 2021 ku vlera e xhiros së kërkuar, nuk duhet të jete me e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet, si dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare 2019, 2020,2021.

Per të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit, një vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore, për xhiros vjetore të realizuar në 3 vitet e fundit financiare, 2019,2020, 2021 konform akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi, ku të jete pasqyruar vlera e xhiros për secilin vit të periudhës së kërkuar në kërkesat për kualifikim.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur, nëse Operatorët ekonomikë pjesëmarrës arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, në dokumentat e tenderit.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit të operatoreve ekonomikë, në raport me përqindjen dhe ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, konform dispozitave ligjore dhe nenligjore në fuqi, për prokurimin Publik.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare konkretisht te viteve financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, konform legjislacionit tatimor ne fuqi ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin ne proceduren e prokurimit pervec bilanceve tatimore dhe akt ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel i autorizuar, per tre vitet e kerkuara ne dokumentat e tenderit, konkretisht per tre vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021.

Autoriteti kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne proceduren e prokurimit publik, per plotesimin e kerkesave per kapacitetin ekonomik dhe financiar.

Per plotesimin e ketij kriteri per kualifikim, duhet te paraqitet ne proceduren e prokurimit publik deklarate me shkrim nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues, sipas percaktimit te bere ne kete pike te kerkesave per kualifikim, pjese e dokumentave te tenderit.

Ne rast deklarimi te pasakte apo te rreme, do te veprohet konform parashikimeve te Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin Publik", si dhe VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

2.2.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit një vërtetim që ofertuesi ka paguar taksat dhe tarifatat vendore per vitin 2022, për cdo vend te ushtrimit te aktivitetit, sipas parashikimeve te dhena ne Qendren Kombetare te Biznesit.,

Ne rastet e bashkimit te Operatoreve Ekonomike, cdo anetar i grupit te Bashkimit te shoqerive duhet te paraqese vertetimin per pagesen per taksat dhe tarifatat vendore per vitin 2022 konform parashikimeve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) deshmi per realizimin me sukses te nje apo disa kontratave, per sherbimet e meparshme, te ngjashme me objektin e prokurimit, ne nje vlere jo me te vogel se 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet si dhe që është realizuar gjate tre viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlere, afati i perfundimit te kontrates ose fatura tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku te jene shenuar datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar ne sektorin privat si deshmi do te pranohen vetem fatura tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te jene te shenuara datat, shumat dhe sasite dhe sherbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar prej 19 punonjesish te siguruar per periudhen Korrik 2022 - Tetor 2022 ne dokumentat e tenderit. Per plotesimin e ketij kriteri duhet te paraqesin vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore ne te cilin te jete i

percaktuar numri i punonjesve te siguruar per cdo muaj konform legjislacionit ne fuqi, per te gjithë periudhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit.

Operatoret ekonomike ofertues se bashku me vertetimin ku te jete i pasqyruar numri i punonjesve sipas kerkeses per kualifikim, duhet te paraqesin ne tender edhe listepagesat perkatese sipas formularit E/Sig-25, per Kontributet e Sigurimeve Shoqerore dhe shendetesore, te punonjesve, sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni Tatimor ne fuqi, per te gjithë periudhen e kerkuar konkretisht, Korrik 2022 – Tetor 2022 sipas legjislacionit ne fuqi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

2.3.3 Operatoret ekonomike ofertues , duhet te dorezojne ne tender nje deklarate me shkrim nga ofertuesi qe enti/ Autoriteti kontraktor rezervon te drejten te kryeje ne cdo kohe verifikimin fizik te disponueshmerise se mjeteve me apo pa paralajmerim paraprak, si dhe te bejne deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve teknologjike , me qellim verifikimin e tyre.

Gjithashtu, Ofertuesi duhet te deklaroje me shkrim se eshte dakort qe mjetet te paraqiten prane komisionit te posaçëm për verifikimin e tyre, ne vendin qe do te percaktoje Autoriteti Kontraktor, ne rast se lindin dyshime për verifikimin e tyre nga shqyrtimi i dokumentacionit, si dhe transporti i tyre do te behet me shpenzimet e vete operatorit ekonomik ofertues.

Per plotësimin e ketij kriteri për kualifikim, te paraqitet ne tender deklarate me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese, sipas te gjithë përcaktimit te bere ne kete kriter për kualifikim, pjese e dokumenteve te tenderit.

Mosparaqitja e kësaj deklarate ne formën dhe menyren e kerkuar ne kerkesat për kualifikim, perben kusht për skualifikim nga procedura e prokurimit te ofertuesit.

Dhenia e informacionit te rreme, perben kusht për përjashtimin e te gjithë ofertuesve që do të paraqesin informacion dhe dokumentacion qe permban te dhëna te rreme për qellime kualifikimi.

2.3.4 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin ne procedurën e prokurimit publik licensën profesionale te shoqërise, e cila duhet te jetë e vlefshme me kategorine per sherbime profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis, sipas kodit III.2.B, te leshuar nga organi Institucioni kompetent Shteteror për grumbullim, transportim te mbetjeve urbane.

Gjithashtu, kjo license duhet të jete e shoqëruar me akt miratimin e licenses e kategorise III.2.B, leshuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, për grumbullim dhe transportim te mbetjeve urbane.

2.3.5 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kete staf mbeshtetes, per realizimin e objektit te prokurimit, te paktën nje specialist për klasifikimin e mbetjeve dhe menaxhimin e tyre sipas Legjislacionit Shqiptar dhe direktivave Europiane, per te cilin duhet te paraqiten ne proceduren e prokurimit publik kontrata e punës/sherbimit e vlefshme, si dhe dokumenti/certifikata ku te provohet kerkesa e mësipërme për kualifikim.

2.3.6 Operatoret ekonomike ofertues duhet te dorezojne ne tender nje deklarate me shkrim nga Administratori i shoqerise ofertuese, që do të fshije /pastroje siperfaqet ne zonen urbane te qytetit me automjete teknologjike bashkekohore, sipas kerkesave per kualifikim pjese te dokumentave te tenderit dhe sapecifikimeve teknike, te cilat duhet te jene ne dispozicion te ketij objekti.

2.3.7 Operatoret ekonomike fitues duhet te jene te punesuar ne shoqeri te pakten 2 persona te pajisur me certifikata te Aftesimit Profesional per mjetet teknologjike per te cilat duhet te paraqitet ne tender kontrata e vlefshme e punes, deshmia profesionale, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per gjithe periudhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit.

2.3.8 Operatoret ekonomike ofertues duhet te paraqesin ne tender deklarate me shkrim nga Administratori i shoqerise ofertuese, per disponueshmerine e mjeteve gjate periudhes se kryerjes se sherbimi, sipas dokumentave te tenderit.

2.3.9 Operatoret ekonomike ofertues duhet te jene te punesuar ne shoqeri, te pakten 1 person te perfshire edhe si drejtues teknik, te diplomuar ne biologji mjedisore per te cilen duhet te paraqitet ne tender kontrata e punes e vlefshme, diploma, librezja e punes, si dhe te figuroje ne listepagesa e shoqerise ofertuese, per te gjithe periudhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit.

2.3.10 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin ne procedurën e prokurimit vertetim nga Drejtoria Rajonale e Transportit/Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ku te konfirmohet qe shoqeria ofertuese, nuk eshte debitore per taksat vjetore i mjeteve ne pronesi, gjoha te kontrollit teknik apo gjoha te tjera për te gjitha mjetet qe do te ofertojne në tender.

2.3.11 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te jene pjese te stafit te tyre, i cili duhet te figuroje ne listepagesat e shoqërise, per të gjithe periudhën e kerkuar ne dokumentet e tenderit, nje punonjes te kualifikuar sipas formimit profesional per veglat e dores manuale dhe ato me energji, sipas legjislacionit ne fuqi.

Per plotesimin e këtij kriteri për kualifikim, Kandidatet/Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin ne procedurën e prokurimit kontratën e punës te vlefshme, si dhe dokumenti i formimit profesional, i leshuar nga institucione shteterore ose kompani te licensuara në fushën e formimit profesional, e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise për kurset e formimit profesional.

2.3.12. Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te deklarojne se makinerite teknologjike te kerkuara ne kerkesat për kualifikim, nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera, apo ne asnjë punemarrje tjetër publike apo private.

Per plotesimin e ketij kriteri për kualifikim, pjese e dokumenteve te tenderit, Operatorët Ekonomike ofertues duhet te paraqesin ne tender deklarate me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese. Mosparaqitja e kësaj deklarate ne formën dhe mënyrën e kerkuar, sipas percaktimit te bere ne kerkesat për kualifikim, perben kusht per skualifikim.

Dhënia e informacionit te rreme, perben kusht per penalizimin/perjashtimin e te githe të rreme, sipas parashikimeve te legjislacionit te prokurimit publik.

2.3.13 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin ne procedurën e prokurimit publik certifikatat perkatëse te vlefshme te ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalentet te tyre, dokumente te cilat duhet të jene te lëshuara nga organizma nderkombetare ose shoqëri te akredituara në Republiken e Shqipërise, si dhe të cilat duhet te jene te vlefshme ne datën e hapjes se procedures se prokurimit publik, si me poshte: Certifikatën ISO 9001:2015 (certifikatën e Menaxhimit te Cilësise se Punimeve, ose ekuivalenten e saj Certifikatën ISO 14001:2015, për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, ose ekuivalenten e saj.

2.3.14 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kete pjese te stafit te tij, i cili duhet te figuroje ne listepagesat e shoqërisë, per te gjithe periudhën e kerkuar ne dokumentet e tenderit, te pakten nje punonjes te kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun e menaxhimit e agjentëve kimike, sipas legjislacionit ne fuqi.

Per plotesimin e ketij kriteri per kualifikim, duhet te paraqitet ne procedurën e prokurimit kontrata e punës e vlefshme dhe dokumenti i formimit profesional, i leshuar nga institucione shtetërore ose kompani te licensuara ne fushen e formimit profesional, e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise për kurset e formimit profesional.

2.3.15 . Te gjitha makinerite teknologjike që do te përdoren për shërbimin e pastrimit, sipas ketij objekti prokurimi, duhet te jene ne përputhje me te dhenat teknike dhe specifike dhe konform normave te Komunitetit European, deklarate me shkrim nga Administratori kandidatit/ofertuesit.

2.3.16 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te disponojne ne stafin e tij, i cili duhet te figuroje ne listpagesat e shoqërise per te gjithë periudhën e kerkuar ne dokumentet e tenderit, te pakten nje person te certifikuar per menaxhimin e mbetjeve te ngurta, për te cilin duhet te paraqitet në tender kontrata e punes e vlefshme, si dhe dokumentacion/certifikimi që provon kerkesen e mesiperme per kualifikim.

2.3.17 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin në procedurën e prokurimit publik nje deklarate me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese që i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur ne procedurën e prokurimit është i sakte dhe nuk permban te dhena të rreme për qëllime kualifikimi.

Ne plotësimin e kësaj deklarate, ofertuesi duhet te plotesoje dhe te jape te dhënat e sakta te kesaj procedure prokurimi, si objektin e prokurimit, autoritetin kontraktor dhe numrin e References se kesaj procedure.

Mosplotesimi i deklarates ne formen dhe menyren e kerkuar, perben kusht për skualifikim.

Dhenia e informacionit te rreme do te perbeje shkak per penalizimin/perjashtimin e te gjithë ofertuesve që do të paraqesin të dhena të rreme për qëllime kualifikimi.

2.3.18 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin ne procedurën e prokurimit publik deklarate me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese qe autorizon Entin/Autoritetin Kontraktor te beje verifikimet perkatese mbi te gjithë dokumentacionin e paraqitur ne procedurën e prokurimit, prane cdo organi apo institucioni ose autoriteti që i ka leshuar ato, ne rast se do te lindin dyshime mbi vertetësinë e tyre.

2.3.19 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kenë staf mbështetës, për realizimin e objektit te prokurimit, te pakten 1 ekspert që permbush kriteret per te qene koordinator në fushen e sigurise dhe te shendetit ne pune sipas kerkesave te Ligjit nr. 10237, date 18.02.2010 "Për sigurine dhe shendetin ne pune", si dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 «Per miratimin e rregullores "Për sigurine ne kantier", konkretisht për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, per fshirjen me fshese te rrugëve, trotuar dhe sheshe, si he per lagien e rrugëve dhe shesheve me makine teknologjike/autobot, per te cilin duhet te paraqiten ne procedurën e prokurimit publik kontrata e punës/shërbimit e vlefshme, si dhe dokumenti/certifikata ku te provohet kërkesa e mësipërme per kualifikim.

2.3.20 Deklarate me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese qe merr persipër me shpenzimet e veta dhe eshte dakort qe te paraqesi pranë Entit/Autoritetit Kontraktor, mietet teknologjike te kerkuara ne dokumentet e tenderit, ne rast se do të lindi nevoja per verifikimin e tyre perpara shpalljes se klasifikimit/njoftimit te fituesit paraprak.

2.3.21 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kene pjese te stafit te tyre, i cili duhet te figuroje ne listpagesat e shoqërise, per te gjithë periudhën e kerkuar ne dokumentet e tenderit, te paktën nje punonjës te kualifikuar sipas formimit profesional për ngritjet manuale me dore, sipas legjislacionit ne fuqi.

Per plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, duhet te paraqitet ne procedurën e prokurimit kontrata e punës e vlefshme dhe dokumenti i formimit profesional, i leshuar nga

institucione shtetërore ose kompani të licensuara në fushën e formimit profesional, e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për kurset e formimit profesional.

2.3.22 Operatorët Ekonomikë ofertues, duhet të paraqesin në procedurën e prokurimit publik, një deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë ofertuese, ku të deklarojë se të gjithë makineritë teknologjike të kërkuara, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti, deri në përfundimin e plotë të punimeve, sipas kësaj kontrate shërbimi.

2.3.23 Operatorët Ekonomikë ofertues, duhet të disponojnë, në pronësi ose me qira, mjetet e mëposhtme, për kryerjen e shërbimit të pastrimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, si më poshtë:

- Automjet teknologjik copel për heqje dhe transport mbeturinash nga konteneret me kapacitet mbajtës 10-11 ton, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash, i cili duhet të jetë i ri dhe sipas standarteve të BE.

- Automjet teknologjik copel për heqje dhe transport mbeturinash nga konteneret me kapacitet mbajtës 9-10 ton, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash, i cili duhet të jetë i ri dhe sipas standarteve të BE.

- Kontener mbeturinash, 50 cope me kapacitet mbajtës në volum 8-9 m³.

- Kamioncine e vogël, cope 1 me kapacitet mbajtës 1-2 ton.

Të gjitha mjetet duhet të jenë në pronësi ose me qira si dhe të jenë të shënuara në regjistra publike.

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit, certifikatën e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, sigurancën e mjetit, si dhe fotot ku të jenë të dukshme targetet e mjeteve të ofruara.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit në RSH ose faturat tatimore të blerjes, për ato mjete që janë marrë me qira këto dokumenta duhet të jenë bashkëlidhur Kontrates së qirase notoriale, e cila duhet të përfshijë të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit, si dhe të jetë përcaktuar objekti i marrjes në qira, qëllimi dhe destinacioni i mjeteve së bashku me dokumentacionin provues të tyre. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. Mjete në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar shoqëruar me gjithë dokumentacionin e kërkuar si dhe për ato me qira përvëç dokumentave të mesipërme duhet të paraqitet kontrata e qirase e vlefshme deri në afatin e përfundimit të Kontrates së shërbimit të pastrimit. Do të njihen vetëm mjetet e paraqitura në pronësi ose me kontratë qiraje ose sipas LSH në fuqi. Nuk do të pranohet blerja e mjeteve me kusht apo me kontratë paraprake blerje. Çdo makineri duhet të jetë e shoqëruar detyrimisht me dokumentacionin e mesipërme të kërkuar në kërkesat për kualifikim.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

2.3.24 Kandidatët/Operatorët Ekonomikë ofertues, duhet të kenë pjesë të stafit të tyre të paktën një person të certifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë sipas standartit ISO 45001, për të cilin duhet të paraqitet në tender kontratë pune të vlefshme, si dhe dëshmi të kualifikimit/certifikata që provon kërkesën e mësipërme për kualifikim, si dhe të figurojë në listpagesat e shogërisë për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit.

2.3.25. Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te dorëzojne ne tender një deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë ofertuese se, te gjitha dokumentet e paraqitura ne kete procedure prokurimi jane te sakta, si dhe deklarate se mjetet teknologjike e ofertuara ne kete tender nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera, si dhe nuk jane deklaruar ne procedura te tjera, ne te cilat kontrata nuk është perfunduar ende dhe ne kontrata ne te cilat kanë marrë pjesë dhe nuk është shpallur ende fituesi. Mosparaqitja e kësaj deklarate ne formën dhe mënyrën e kërkuar, perbën kusht për skualifikim. Dhenia e informacionit te rreme, perbën kusht për penalizimin/përgjashtimin e te gjithë ofertuesve që do te paraqesin të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

2.3.26. Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te kete staf mbeshtetes, për realizimin e objektit te prokurimit te paktën nje Inxhinier Agro-Mjedisi, te certifikuar për përdorimin e pajisjeve te punës dhe te pajisjeve mbrojtëse, per te cilin duhet te paraqiten në procedurën e prokurimit publik kontrata e punes/sherbimit e vlefshme, diploma, si dhe dokumenti/certifikata ku te provohet kerkesa e mesipërme.

2.3.27 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kete ne pronësi ose me qira, nje ambjent me siperfaqe të mjaftueshme, te paktën minimalisht 1000 m², i cili do te sherbeje për parkimin e mjeteve jashte orareve te sherbimit, depozitimit dhe riparimin e kontenierëve te dëmtuar, si dhe për depozitimin e materialeve që i nevojiten shoqërisë ofertuese, për realizimin e plotë te sherbimit te pastrimit. Ambjenti duhet te kete servis për mirëmbajtjen e mjeteve (ose kontrate shërbimi me një servis te autorizuar për riparim mjetesh, provuar me dokumentacion provues dhe vertetues mbi riparimin e mjeteve), si dhe uje te bollshëm për larjen e mjeteve dhe kontenierëve, si dhe sistem kamerash, shoqëruar me fotot, kontratën dhe dokumentacion ku te plotesohet dhe vertetohet do kerkesa e mësipërme për kualifikim, ambjent i cili duhet te jete ne pronësi ose me qira.

2.3.28 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kete staf mbeshtetes, për realizimin e objektit te prokurimit të paktën një specialist për sistemin e menaxhimit te mjedisit dhe te mbetjeve, për te cilin duhet te paraqiten ne procedurën e prokurimit publik kontrata e punes/sherbimit e vlefshme, si dhe dokumenti ku te provohet kerkesa e mësipërme për kualifikim.

2.3.29. Operatori Ekonomik ofertues, duhet te paraqesi ne procedurën e prokurimit, së bashku me oferten e tij edhe preventivin, i cili duhet te jete i shoqëruar me analizën e çmimeve. Mosparaqitja në formën dhe mënyrën e duhur, perbën shkak per skualifikimin e ofertes ofertuese. Mosargumentimi i cmimit te ofertuar, sjell si pasoje skualifikimin e ofertës ofertuese.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne te gjitha rastet e kerkesave per makinerite, stafin dhe personelin e kerkuar, disponimi i tyre dhe plotësimi sipas kerkeses për kualifikim, do te deshmohej nepërmjet formularit permbledhes te vetëdeklarimit dhe keto dokumente te kerkuara ne kriteret e vecanta te kualifikimit , do te paraqiten nga operatori ekonomik fitues, perpara se AK te jape kontraten, si dhe duhet te jete ne dispocizion ne cdo kohe per verifikim nga operatori ekonomik fitues.

Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i regjistruar në një vend të huaj, atëhere mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me regjistrim të përkohshme cila vërtetohet nëpërmjet dokumentit hyrës ose një deklarate nga institucionet shtetërore, si dhe të jetë shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive. Dokumentacioni tjetër, sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesës për kualifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i parë duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Vertetimi i oshe duhet te jete sipas parashikimeve ligjore ne fuqi, dokument ky i cili duhet duhet te administrohet nga shoqeria ofertuese ne tender.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

